



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale
Mbledhja nr. 58
Prishtinë, më datë 3 mars 2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I DËGJIMIT PUBLIK TË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, PUNËS
DHE MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Vezira Emruš dhe Bujar Bukoshi .

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore , dhe Hekuran Gashi –praktikant , Rrezarta Ahmeti – KDI , dhe Lejla Selimi nga OSBE ja .

Të ftuar: Fatime Aliu , Flakron Sylejmani Arianit Jakupi , Haki Ejupi , Arsim Maloku, Basri Rexha, Rifat Muriqi nga ministria e shëndetësisë, Skender Musa, Ahmet Hoxha, Belkize Shalqini, Labinot Halilaj, Mendim Sojena, Ismajl Shurdhaj, Selvete Qehaja , Blerina Berisha , Arsim Ibrahimimi nga AKPM ja , Nexhdet Kondirolli nga kompania „ Kondirolli’’, Azem Lajqi nga kompania „, Farmakos’’ Kadri Bytyçi , Adnan Mustafa nga SHFK , Faton Çitaku SHDFMK, Armend Agani nga SHDFMK „, Agani’’ Adnan Bozaliu ,Enkeleda Xhonbalaj nga QKUK, Hysni Guraziu nga Hebpharma , Milajim Avdullahu nga Andefarm, Lulzim Çela nga UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Dëgjim Publik lidhur me Projektligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Sadik Idriz – Kemi organizuar këtë dëgjim publik për Projektligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale sipas propozimit të grupit punues në përbërje: Rita Hajzeraj -raportuese dhe Bujar Bukoshi e Qamile Morina – anëtar. Projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës edhe pse ka pasur vërejtje të shumta. Kemi të ftuar sponsoruesit e projektligjit dhe shumë palë të interesuara për këtë ligj. Edhe pse ka pas një ligj të vjetër, sponsoruesi ka proceduar në Kuvend një ligj të ri e jo plotësimin e ligjit të vjetër. Në këtë dëgjim jemi të interesuar ti dëgjojmë të

gjithë të pranishmit me propozimet dhe sugjerimet e tyre në mënyrë që ta kemi një ligj sa më të mirë. Hap diskutimin dhe ju jap fjalën fillimisht sponsoruesit e pastaj të gjithë të pranishmëve.

Flakron Sylejmani – Ministria e Shëndetësisë ka filluar procedurën për hartimin e këtij ligji duke par nevojën dhe kërkesën e parashtruar nga shoqatat dhe grupet tjera të interesit. Ministria ka formuar grupin punues ku kanë qenë të përfshirë AKPM , SHFK, katedra e farmacisë dhe shumë ekspert tjerë. Pas përfundimit të punës në Ministri, ligji është proceduar te Qeveria e Kosovës. Ligji ka kaluar në shumë debate dhe është plotësuar me propozimet e grupeve të ndryshme të interesit. Ky ligj është i propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe ka mar miratimin edhe nga Qeveria.

Skender Musa – Iniciativa për ndryshimi e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale është marr nga AKPM , me qëllim që të ndërrohet pozita juridike e agjencionit dhe që AKPM të merr pozitën e një agjencionit të pavarur siç e kanë edhe shtetet evropiane dhe shtetet e regjionit. Pas përfundimit të punës në grupin qeveritar ligji ka kaluar në ministrin e shëndetësisë dhe më pas AKPM nuk ka pas më qasje në procedurat e mëtejshme që janë zhvilluar dhe ku nga drafti fillestar janë fshi shumë dispozita të cilat janë të kërkueshme nga direktivat e bashkimit evropian për agjencionet e pajisjeve dhe produkteve medicinale. *Propozojmë që,, në nenin 3 të thuhet që AKPM të jetë institucion i pavarur në vendimmarrje dhe në çështje financiare dhe i cili e rregullon qarkullimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale dhe që i raporton Kuvendit të Kosovës. Funksionimin dhe Kompetencat AKPM -ja i ushtron në bazë të këtij ligji.* Kjo është e paraparë edhe me nenin 142 të kushtetutës së Republikës së Kosovës. *Në nenin 4 Komisioni i Kosovës për Vlerësimin e Produkteve dhe pajisjeve Medicinale (KKVPM) i cili emërohet nga kryeshefi i AKPM është përgjegjës për dhënien e këshillave AKPM së.* Dallimi në mes këtij neni dhe draftit që ju e keni përpara është se ne dëshirojmë që ta caktojmë autoritetin kompetent për emërimin e komisionit. Në ligjin e vjetër ka qen neni 4 ku e ka caktuar si autoritet kompetent AKPM për e emërimin e këtij komisioni. Në nenin 4 paragrafi 2 pika 9, Bordi i Ankesave dhe Parashtrësave , ju e dini që edhe në ligjin e vjetër kompetent për emërimin e Bordit të ankesave dhe parashtrësave ka qenë AKPM , prandaj kërkojmë që në vend të Ministrisë së shëndetësisë të jetë AKPM- ja. Licencimi i Barnatoreve Difuzive në ligjin e vjetër në disa nene ka qen që licencimin e bën AKPK ja në disa tjera ka qen që e bën ministria , në praktik është aplikuar që licencimin e ka bërë AKPM si institucion i specializuar. Në nenin 19 inspektorati sipas ligjit të vjetër ka qenë në kuadër të AKPM , tani sipas një marrëveshje është në kuadër të MSH. AKPM -ja është agjenci ekzekutive dhe veprimtarin e vet nuk mund ta ushtroj pa inspektorat. AKPM ja ka parapa të krijohet inspektorati profesional i cili e kontrollon produktin dhe pajisjen medicinale nga faza e prodhimit deri në shpërndarjen përfundimtare. Në nenin 31 kompetencat e autoritetit kompetent propozojmë të shtohen nenet që kanë qen në draftin e grupit qeveritar. Kërkojmë që të rregullohet që punëtorët e AKPM nuk janë shërbyes civil dhe që AKPM të ketë të drejt të nxjerr statusin për organizimin dhe funksionimin e brendshëm. Në nenin 31 paragrafi 2 pika 14 të shtohet që AKPM i raporton Kuvendit të Kosovës përmes kryeshefit ekzekutiv. Në paragrafin 15 Kuvendi i Kosovës të formoj bordin mbikëqyrës të AKPM së. Te rregullimi i çmimeve kemi marr mostër Republikën e Shqipërisë që rregullohet me vendim të këshillit të ministrave .

Kadri Bytyçi – SHFK sugjeron që AKPM të jetë një institucion i pavarur nga ministria . Gjithashtu për një funksionim më efikas AKPM duhet ta ketë nën mbikëqyrje inspektoratin ashtu si ka qen në fillim të themelimit të agjencionit. Edhe vendet e rajonit e kanë të rregulluar në këtë formë. Kërkojmë që edhe një anëtar i shoqatës sonë të jetë i kyçur në grupet punuese për amendamentimin e këtij ligji.

Adnan Mustafa – Ka shumë çështje të këtij ligji që janë në kohezion edhe me shumë ligje tjera dhe duhet që ministria me ligjet e shëndetësisë të shkoj me një pako të ligjeve. AKPM duhet të jetë institucion i pavarur i themeluar nga Parlamenti. AKPM ka të drejt që kërkon të jetë i

pavarur. Materie e këtij ligji duhet të jen vetëm bari dhe pajisja medicinale , ndërsa AKPM merret edhe me farmacistët edhe farmacitë që nuk duhet të jetë materie e këtij ligji por e ligjit për farmacinë. Mangësi e këtij ligji janë hulumtimet klinike. Në Kosovë 2000 deri në 3000 lloje të barnave kontrabantohen. Kam propozuar që farmacia ta ketë të drejtën e importit për një pacient nga vendet e bashkimit evropian. Ky ligj siç është ka me e rrit kontrabanden e barnave sepse edhe procesi i regjistrimit të barnave është duke u zvarrit shumë me qëllim. Propozoj që në këtë ligj të hyj që,, *farmacitë ta kenë të drejtën e importit të një bari apo të një cikli të trajtimit i cili nuk mund të zgjat më shumë se tre muaj*”. Rregullimi i çmimit të barnave si është e shkruar në ligj paraqet ndërhyrje të shtetit në politiken e çmimeve sepse në ligj thuhet se ministria e shëndetësisë bashkë me disa institucione tjera caktojnë çmimin e barnave. Duhet të flitet për rregullim por jo për caktim të çmimeve. Gjithashtu në ligj thuhet se nuk guxon të blihen barna me internet , ajo është një çështje absurde sepse asnjë shtet nuk e ndalon.

Gjylnaze Sylja – Në lexim të par nuk e kam përkrah këtë Projektligj prandaj jam e interesuar të dëgjoj në këtë takim për zgjidhjet e ofruara me këtë ligj. Pyes Ministrinë e Shëndetësisë se ky ligj në krahasim me ligjin e vjetër , cili është koncepti i ri i këtij ligji në aspektin e mbrojtjes së shëndetit të popullsisë , në aspekt të kontrollës së barnave dhe pajisjeve medicinale?

AKPM e pyes që pasi po kërkon të jetë i pavarur a keni propozim për mënyrën e funksionimit dhe mekanizmat tuaj mbikëqyrës dhe të kontrollit?

Z.Muztafa e pyes që pasi propozoj që farmacia të ketë të drejt të importoj barna nga BE ja, si është e rregulluar kjo në shtetet tjera ?

Sa i përket çmimit të barnave si propozoni ju që kjo çështje të rregullohet?

Rita Hajzeraj – Duke e pas parasysh rëndësinë e këtij ligj , i cili është ligj për produkte dhe pajisje medicinale jo ligj për statusin e AKPM . Edhe sa i përket nenin 142 të Kushtetutës agjencionet e pavarura duhet të themelohen me ligj të veçantë. Me këtë ligj është e pamundur të ndërroj statusi i AKPM . Dëshiroj të dëgjoj se cilat janë propozimet tuaja progresive që ligji të jetë sa më funksional. Në nenin 9 janë barnatoret dhe dispensimi i produkteve , dëshiroj të di se a ka qen edhe deri me tani kështu e rregulluar apo kjo është risi në këtë ligj. Në nenin 2.12 të punësuarit në AKPM thuhet se nuk janë shërbyes civil, ky ligj nuk mund ta rregulloj statusin e punëtorëve , janë ligjet tjera që e rregullojnë këtë çështje.

Shqipe Gashi – Nga Farma Swis, ku ne si kompani bëjmë regjistrimin e më shumë se 10 kompanive botërore. Ne kemi shumë pengesa në regjistrimin e barnave. AKPM nuk ka qen kurrë më i pavarur nuk i përgjigjet askujt. Kemi të bëjmë me mosrespektimin e ligjit. Më se 9 muaj pritet për regjistrimin e një bari.

Teuta Hadri – Me ligjin e ri është shkel Kushtetuta dhe pavarësia e AKPM . Agjencioni i ka kompetencat e veta dhe nuk duhet ti cenohen ato kompetenca. Derisa AKPM krijon të hyra për buxhetin e Kosovës për më shumë se 1 milion euro ndërsa i ndahet buxhet vetëm 200 mijë euro kjo është e papranueshme. Ishte për ne edhe shqetësuese një vizitë në kompaninë ,, Kondiroli “ dhe gjendja është e mjerueshme ku një aparaturë me miliona rrinë për shkak të procedurave të AKPM. Kam vërejtje te ligji i ri dhe mendoj se ligji i vjetër është më i mirë se ligji i ri.

Hysni Guraziu – Ligji për ushqimin i miratuar nga Kuvendi , në nenin 22 pika 2 thotë MSH me akte nënligjore rregullon emërtimin e ushqimeve për nevoja të veçanta në pajtim me këtë ligj. Neni 12 pika 3 thotë MSH përcakton kushtet e prodhimit të ushqimit me nevoja të veçanta. Duke u bazuar në këtë ligj propozoj të fshihet neni 11 pika 3.7 sepse është në kundërshtim me ligjin e ushqimit. As në ligjin në fuqi dhe askund në asnjë shtet evropian , produktet që konsiderohen si ushqime për nevoja të veçanta siç janë produktet herbale, ushqimet për fëmijë etj, nuk konsiderohen si laboratorë galene. Bordi i ankesave nuk funksionon në ministrin e

shëndetësisë. Propozoj që nenit 3 pikës 1,2 ti shtohet një fjali „*në qoftë se janë të regjistruara si medikamente*“.

Nexhdet Kondirolli – Pajtohem se ligji i përparshëm ndoshta ka qenë ma i mirë se ligji i tashëm. Laboratorët galenë kanë depërtuar në treg në mënyrë të pa ligjëshme për shkak të mangësive që i ka pas ligji. Edhe në ligjin e ri, laboratorët galenë nuk kanë nevojë as me u regjistruar, as me paguar taksa, as me importuar materiale, as me certifikuar, as ta bëjnë analizën e kualitetit por ka të drejtë të del në treg prodhuesi i medikamenteve që nuk janë industriale por që janë produkte farmaceutike. Termi galenë në botë nuk ekziston, prodhuesi është prodhues. Laboratorët galenë punojnë tash 10 vite me dhjetëra e mijëra produkte, ndërsa ne me fabrikën ma moderne tash pesë vite nuk kemi mundur të regjistrojmë vetëm 5 produkte. Në Kosovë funksionojnë 4 laboratorë galenë. Prodhuesi është prodhues si prodhues galenë si në fabrikë prandaj duhet të plotësojë kushtet e prodhimit.

Kamë vërejtje edhe të termi person i kualifikuar, pra person i kualifikuar është personi sipas shkollës që e ka të kryer e jo sipas gradimeve shkencore. Personi i kualifikuar duhet të jetë personi i cili jap përgjegjësi për punën që e bën në atë lami. Askund në ligj nuk shkruan që bari i pa regjistruar nuk mundet me qarkulluar.

Milajim Avdullahu - Besojë që një mbledhje si kjo ndikon shumë pozitivisht në krijimin e një ligji sa ma të mirë. Kam tri pika të cilat dëshiroj ti cek. Një, ju lutem që të mos bëni krahasimin e ligjeve të vendit tonë me vendet e Bashkimit Evropian për arsye të kushteve jo të njëjta ekonomike dhe sociale me këto vende. Është pozitive që të bëjmë një ligj që akordohet me legjislacionin evropian por duhet marrë parasysh parametra e popullatës dhe të nivelit ekonomik. Nën dy, propozoj që të bëni një rregullore më fleksibile sa i përket produkteve medicinale që vinë nga zona e Shengenit dhe të ju lesohet procesi i regjistrimit. Sugjeroj që kjo procedurë të konsiderohet e kryer me posedimin e vërtetimit mbi prejardhjen dhe prodhimin e produktit si dhe me dëshmi për pagesën e taksës. Kjo bën të mundur që qytetarët të kenë medikamentet adekuate cilësore në kohë sa më të shkurt. Dhe nën tre, sugjeroj që procesi i aplikimit për regjistrim të barit ose produktit medicinal të mos rregullohet me udhëzim administrativ, si më parë dhe që periudha për aplikim prej 30 dite të mos e lërë të hapur mundësinë e dorëzimit të dokumentacionit adekuat edhe pas periudhës 30 ditore. Ky veprim ndikon që prodhuesit e mëdhenj të medikamenteve të mos ndihen të favorizuar për plasimin dhe shitjen e produkteve në tregun Kosovë, duke marrë parasysh madhësinë e tregut dhe numrin e popullatës. Dhe në fund, të kemi kujdes në rregullimin e përshkrimit të produktit në pjesën e jashtme. Rregulloret dhe ligjet e ndryshme kanë kërkuar që së pari përshkrimi në pjesën e jashtme të bëhet në shqip, pastaj në serbisht, e më vonë edhe turqisht. Kjo paraqet problem për prodhuesit e barërave. Shumë prej prodhuesve refuzojnë që të bëjnë përshkrimin e produktit në më shumë se një gjuhë zyrtare të shtetit relevant.

Adnan Bozaxhiu – Nuk kuptoj që anëtarët e grupit punues tani prapë po kanë propozime dhe kundërshtime. Ligji i vjetër ka qenë në pajtueshmëri me ligjet e Bashkimit Evropian dhe direktivat e BE. Ky ligj i propozuar brenda një viti prapë do të kthehet në Parlament për tu ndryshuar sepse nuk është një ligj i mirë. Ky ligj nuk duhet të caktoj çmimet por çmimet caktohen me ligje tjera dhe me negociata. Ministria e shëndetësisë duhet ta bëjë ligjin e shëndetësisë, ligjin mbi rimbursimin e barnave në mënyrë që ta negociojë çmimin e barnave. Tri shtylla janë kryesore të këtij ligji pra siguria, kualiteti dhe efikasiteti, nëse njëra prej tyre mungon ligji nuk do të jetë ligj i mirë.

Rifat Muriqi – Neni 3 pika 1.58 shkruan që personi i kualifikuar në prodhim duhet të certifikojë çdo seri të produktit medicinal para lëshimit të tij në tregun e Kosovës sipas direktivës 2001/83 KE, e cila përkufizon përgjegjësitë e personit të kualifikuar. Ky është gabim sepse kjo direktivë 2001/83 KE nuk është në rregull sepse kjo direktivë ndryshe e përkufizon personin e kualifikuar.

Neni 19 pika 3 është në kundërshtim me çdo direktivë evropiane. Kemi bërë propozim konkret me shkrim për këtë nen.

Kërkesa jon e tret është që nëse dëshironi ligji të jetë në pajtim me ligjet dhe direktivat e BE, duhet që inspektorati i farmacisë të jetë në kuadër të AKPM - së jo në kuadër të ministrisë.

Behide Shalqini – Të gjitha agjencionet në rajon kanë mbi 100 punëtor ndërsa agjencioni jon ka vetëm 37 punëtor për këtë arsye kërkojmë të pamvarësohemi në mënyrë që të kemi numrin e nevojshëm të punëtorëve.

Armend Agani – Disa kërkesa tona si shoqatë e distributorëve nuk na janë përfill andaj dëshirojmë ti shtrojmë para këtij komisioni. Përkrahi propozimin që AKPM të ketë të drejt në pavarësim financiar dhe në një numër më të madh të stafit , por nuk e përkrahi pavarësimin e plotë të agjencionit. Problem tjetër për ne paraqet pritja me muaj për dorëzim të aplikacionit për regjistrim të produktit në AKPM . Kemi kërkuar lehtësime për regjistrim të produkteve që janë të regjistruara në EMEA .

Qamile Morina – Në një vizitë në një kompani për prodhimin e barnave kemi mësuar se produktet galene prodhohen në seri më të mëdha dhe shpërndahen në treg , kjo nuk lejohet sipas standardeve evropiane.

Kompanitë që merren me produkte farmaceutike kërkojnë që procedurat e regjistrimit të jen të qarta dhe në një periudhë kohore të arsyeshme .

Askund në ligj nuk ka përgjegjësi për produktet që kanë autorizim marketing dhe që kanë shkaktuar dëm në treg. Kush duhet ta bëj sistemin e farmakovigjilencës ? Mungon neni i testimit të produkteve medicinale.

Në ligj shkruan se ministri i shëndetësisë mund të lidh marrëveshje bilaterale me vendet e BE dhe vendet tjera për pranimin e autorizim marketingut në mënyrë të një anshme.

Të gjitha këto kanë nevojë për tu sqaruar në ligj.

Rita Hajzeraj – Dëshiroj të di se në çfarë pavarësimi financiar i AKPM mendohet të bëhet sepse Ministria e Shëndetësisë duhet të bëj më shumë që ta ngritë buxhetin e AKPM së.

Dëshiroj të di se cilat janë risit më të avancuara të projektligjit në krahasim me ligjin e vjetër.

Nurishahe Hulaj – Kërkoj interpretim të nenit 142 të Kushtetutës, se a duhet që me një ligj të rregullohen të gjitha agjencionet e Republikës së Kosovës apo si mund të interpretohet ky nen. Inspektorët Farmaceutik kanë kërkuar që në Projektligj të futet që edhe kimistët munden me qen inspektor farmaceutik , kërkoj përgjigje nga profesionistët se a mundet me qenë edhe kimisti inspektor farmaceutik apo nuk munden me qenë?

Vezira Emrush – Kemi shumë propozime për projektligjin , dhe nga ajo që u diskutua kërkoj një përgjigje se ligji a e rregullon prodhimtarin apo e rregullon buxhetin. Ne duhet të kërkojmë nga Qeveria që ti përkrah prodhuesit dhe ta përkrahim edhe punësimin në këtë sektor shumë të rëndësishme .

Është i nevojshëm decentralizimi i fushës farmaceutike dhe të mos shkelen ligji për konkurrencën dhe ligji për mbrojtjen e konsumatorëve.

Flora Brovina – Problemet në sektorin farmaceutik janë shumë të mëdha por ne kemi në shqyrtim ligjin që ta plotësojmë .Cilat ligje tjera i nevojiten sektorit farmaceutik përveç këtij ligji në mënyrë që problemet në këtë fushë të minimizohen.

Do ta gjejmë një zgjidhje të arsyeshme edhe për statusin e AKPM-së.

Flakron Sylejmani - Janë disa propozime të arsyeshme të deputetes Morina të cilat mund të përfshihen në këtë Projektligj. Sa i përket statusit të AKPM së , rregullorja 2001/19 përcakton

kompetencat e të gjitha ministrive dhe të Qeveris po ashtu edhe të AKPM. Agjencioni nuk është rregullator , është agjencion ekzekutiv. Gjithashtu nuk e kuptoj pavarësinë financiare dhe në vendimmarrje të AKPM – së sepse shefi i AKPM i raporton drejtpërdrejt ministrit dhe e ka buxhetin e vet dhe ka të drejt në vendimmarrje . Sa i përket punësimit ministria e shëndetësisë propozimin e AKPM e dërgon në ministrin e financave. Gjithashtu AKPM gjeneron mjaft të hyra por të gjitha të hyrat vetanake në Kosovë derdhen në buxhetin e Kosovës, këto janë rregullat buxhetore të Kosovës.

Sa i përket bordit të ankesave që u propozua që duhet të jetë në kuadër të AKPM së , nuk pajtohem sepse AKPM bën vet licencimin dhe vet ta ketë edhe bordin e ankesave, kjo është ta kontrollosh vetveten. Gjithashtu u propozua që tu lejohet barnatoreve të bëjnë import të barnave, të sqaroj se ligji lejon importin e barnave nga barnatoret për pacient individual .

Caktimi i çmimit të barnave ka qenë një pengesë në ligjin e vjetër, tani kjo është e rregulluar me këtë ligj.

Nëse vendoset që AKPM të jetë Agjencion i pavarur atëherë kjo duhet të rregullohet me një ligj tjetër të veçantë ashtu si e parashih Kushtetuta për agjencionet e pavarura. Edhe shumë shtete tjera i kanë Agjencionet Farmaceutike në kuadër të ministrisë së shëndetësisë.

Sadik Idriz – Qëllimi i këtij dëgjimi publik është që ta miratojmë një ligj sa më të mirë dhe sa më të zbatueshëm. Diskutimet për këtë ligj do të vazhdojnë edhe në grup punues edhe në komision dhe në fund seanca do ti miratoj edhe amendamentet e propozuara.

Adnan Mustafa – AKPM duhet të jetë institucion i pavarur me përgjegjësi publike dhe që i raporton drejtpërdrejt Parlamentit.

Në krejt Evropë barnatorja mund të importoj një bar për pacientin i cili e kërkon një bar të cilin e ka të përshkruar me recetë të mjekut.

Në vitin 2006 kemi dorëzuar në Komisionin parlamentar të shëndetësisë një rregullore e cila i rregullon çmimet e barnave.

Nexhdet Kondirolli - Edhe ligji i vjetre edhe ligj i ri nuk i përkrah prodhuesit por e përkrah vetëm importin. Ministria e shëndetësisë merr të drejt me shpall situatë të jashtëzakonshme dhe me pru barna të pa regjistruara në Kosovë. Nëse bari është i regjistruar në Kosovë askush nuk e ka të drejtën e importit të atij bari në Kosovë. Tani 10 vjet në emër të emergjencës bëhen importe të pa ligjshme në Kosovë. AKPM tani 10 vjet vetëm lexoj dokumente dhe asnjëherë nuk kanë bërë një verifikim të kualitetit të barit.

Kadri Bytyqi – Ta bëjmë një ligj në përputhje me direktivat e BE -së. Pyetja ime është se kush ka qenë pjesë e grupit ndërqeveritar?

Arbenita Pajaziti – Nenet 7,8 dhe 11 nuk përshkruajn fare çështjen e donacioneve sepse për donacione nuk kërkohet autorizim marketingu ndërsa në nenin 11 thuhet që produktet mund të tregtohen në Kosovë pas marrjes së autorizim marketingut dhe në piken tjetër thuhet se autorizim marketingu nuk nevojitet për disa produkte medicinale por që nuk janë përmend donacionet.

Çështje tjetër janë importet që i bën ministria e shëndetësisë , nuk janë përmend në ligj .

Skender Musa – Pavarësia e AKPM është pavarësi institucionale e agjencionit. Me këtë ligj mund të rregullohet pavarësia e agjencionit. Nuk ka mekanizëm më të mirë që mund ta bëj mbikëqyrjen e AKPM së Komisioni Parlamentar i Shëndetësisë dhe bordi profesional ashtu si e kanë Kroacia dhe Mali i Zi.

Ndryshimet në këtë ligj janë ndryshime substanciale.

Adnan Bozagjiu - Në botë kemi dy lloje të agjencioneve agjencionet rregullative dhe agjencionet ekzekutive . Agjencionet rregullative janë në kompetencë të Parlamentit ndërsa agjencionet ekzekutive në kuadër të Qeveris. AKPM është agjencion ekzekutiv.

Sadik Idriz – Falënderoj pjesëmarrësit dhe presim edhe propozimet me shkrim në mënyrë që ligji të bëhet një ligj sa më i mirë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz